

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

---

**Në ankesën e****AC-I-22-0555-A0001****Paditësi/ankuesi****N T**, fshati R i M, Lipjan.**kundër****E paditura**

**NSH, "Termovent"(në likuidim)**, të cilën e përfaqëson, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Bajram Miftari gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-5011 të datës 22 shtator 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 14 mars 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së C-IV-14-5011 të datës 22 shtator 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

### **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me 1 korrik 2014, paditësi parashtroj në DHPGJS-ë një ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (tutje AL), PRN045-0048, të datës 05 qershor 2014 me të cilën kërkesa e paditësit e datës 08 nëntor 2013 për kompensim për paga të pa paguara shumë prej 450.00 euro, për periudhën kohore janar-mars 2001, ishte refuzuar si e pa vlefshme me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Në ankesë paditësi ka pohuar se ka qenë punëtor që nga viti 1980, fillimisht pranë NSH "Termovent" e cila i është dhënë në komercializim "Dajti" sh.p.k e cila ka hyrë në fuqi në vitin 2001 për një afat 10 vjeçar dhe se tutje në këtë ndërmarrje ka punuar deri në privatizimin e saj. Paditësi e konteston aplikimin e dispozitave ligjore, nga ana e AL, lidhur me parashkrimin duke e konsideruar se sipas rregullores së UNMIKU-ut 1999/24, këto dispozita ligjore nuk duhet të aplikohen. Paditësi ka kërkuar nga shkalla e I-rë e DHPGJSK-së që vendimi i AL të anulohet dhe ti njihet e drejta në kompensim. Ankesës i ka bashkangjitur, kopja e vendimit të AL-së.

Më 5 nëntor 2014, gjykata lëshoj për paditësin vërejtje për ta paguar taksën gjyqësore, duke e njoftuar at se nëse taksat nuk paguhen brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, ankesa do të konsiderohet e tërhequr.

Pas tentimit për dorëzimin vërejtjes, tek paditësi nga fletë kthesa nga ana e personit zyrtar të postës është shënuar një vërejtje me shënimin: "ka vdekur".

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, kishte marrë Aktvendim me datë 15 prill 2022, me anë të cilit i ishte ndërprerë procedura gjyqësore për shkak të vdekjes së palës, udhëzuar nga njoftimi i personit zyrtar.

Më 27 prill 2022, paditësi e kishte njoftuar gjykatën që njoftimi i personit zyrtar nuk është i vërtetë, dhe se ai është gjallë. Parashtruesi i ka bashkangjitur: Kopjen e vendimit të datës 26 prill 2022, lëshuar nga Agjencia për ndihmë juridike falas,

kërkesën për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore dhe kopjen e kërkesës për lajmërimin e pensionimit.

Më 28 prill 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka marrë Aktvendim me të cilin lejoi kthimin në gjendjen e mëparshme, dhe shfuqizoi Aktvendimin e datës 15 prill 2022, me anë të cilit ishte ndërprerë procedura gjyqësore.

Me 20 maj 2022, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë me të cilën AKP-ja pohon se e mbështet qëndrimin e Autoritetit të Likuidimit, i cili ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. AKP-ja pohon se pretendimet ankimore të paditësit nuk janë të argumentuar ashtu siç parashihet sipas Shtojcës së Ligjit për AKP-në. Tutje AKP-ja pohon se kërkesa e paditësit është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Nga të gjitha këto arsye propozon që ankesa e paditësit të hedhet si e pa pranueshme ose të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet Vendimi i AL.

Më 03 qershor 2022, paditësi ka parashtruar përgjigje ndaj mbrojtjes dhe ka theksuar se i kundërshton në tersi thinjeje në mbrojtje të AKP-së dhe se mbetet në tersi pran thënieve të cilat i ka paraqitur në ankesën e tij.

Me 22 shtator 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, ka marrë Aktgjykimin C-IV-14-5011, me të cilin ankesa e ankuesit refuzohet si e pa bazuar, vërtetohet Vendimi i Autoritetit të likuidimit PRN045-0048, i datës 05 qershor 2014. Në arsyetim të vendimit thuhet se duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe 5, po ashtu në bazë të nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS është obligim i palës, në këtë rast paditësit, që në parashtresat e tij me shkrim, ankesën ta paraqesë me një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsyetimit ligjor mbi të cilin vendos qëndrimin dhe argumentimin e saj. Në rastin kur pala pohon, në këtë rast paditësi, të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi.

Shkalla e I-rë ka theksuar në arsyetim të vendimit se lidhur me pagat e pa paguara si dhe kompensimit, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP-së, duke u bazuar në nenin 40 të Shtojcës së Ligjit për AKP mbi prioritetet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 parashihet përmbushja e kërkesave për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person të cilët janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në. Andaj, duke u bazuar në dispozitat e lartëcekuar, mund të konkludohet se, punëtori/ja gëzon të drejtën në paga respektivisht dëmshpërblim nëse: a) pagat e punonjësit, në këtë rast paditësit nuk janë paguar, b) kontrata mbi punën i është ndërprerë para afatit të përfundimit, të saj, c) pushimi nga puna ka ardhur si pasojë i Vendimit të AL-së dhe d) ndonjë veprim nga Agjencia, lidhur me administrimin e ndërmarrjes, shitjes, likuidimit etj.

Shkalla e I-rë, ka konstatuar se nga dëshmitë e parashtruara, paditësi nuk ka dëshmuar të drejtën e tij mbi pagat ashtu siç edhe parashihet sipas nenit 40 të Shtojcës së Ligjit për AKP, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 por edhe nuk ka dëshmuar ndonjë obligim tjetër ashtu siç parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5, po ashtu nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS.

Me 05 tetor 2022, paditësi ka parashtruar pranë Kolegjit të Apelit një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-14-5011 të datës 22 shtator 2022, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet Aktgjykimi i ankimuar, të obligohet AKP-ja ti paguajë paditësit kompensimin për pagat e pa paguara shumë prej 450.00 euro, sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit të NSH-së, ose lënda të kthehet në rigjykim. Po ashtu paditësi ka kërkuar nga gjykata të lirohet nga shpenzimet e procedurës ngaqë i njëjti është përfitues i ndihmës juridike falas.

Paditësi në ankesën e parashtruar pranë Kolegjit të Apelit konsideron se konstatimet e dhen anë aktgjykimin e ankimuar janë të gabuara dhe jo të drejta. Ankuesi pretendon se Aktgjykimi është kontradiktor në vetvete, ngase gjykata pranon se palët kanë dorëzuar prova por gjykata fare nuk i përmend se cilat janë ato. Gjukata nuk ka sqaruar se çka është kontestueses e çka nuk është kontestuese në mes palëve dhe cili është qëndrimi i gjykatës lidhur me provat. Tutje ka shtuar se jo korrektësia e gjykatës ka shkuar deri aty kur e ka ndërprerë procedurën gjyqësore për shkak të vdekjes së palës pa pasur asnjë dokument zyrtar siç është aktvdekja apo certifikata e vdekjes por vetëm është bazuar në të dhënat e postes, e që i njëjti ka qenë duke jetuar. Paditësi/ankuesi konsideron se pretendimi i Gjykatës se kërkesa e paditësit/ ankuesit është e parashkruar, është e pa bazuar ngaqë futja e NSH-së në procedurë të likuidimit është bërë më datë 23 shtator 2013, kësioj ankuesi ka pasur prirje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditore pas kësaj date, e që nuk kanë kaluar as edhe 3 muaj nga ajo datë kur paditësi e ka paraqitur kërkesën për kompensimin e pagave të pa paguara më 08.11.2013. Andaj vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH-së, nuk mund ti atribuohet punëtoreve, dhe kësioj t'i mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi është njoftuar se kërkesat kreditore që mund t'i ketë, duhet t'i parashtrorë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Paditësi në ankesë po ashtu thekson se Autoriteti i Likuidimit-AL në rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e tij për kompensimin për paga të pa paguara, në shumë prej 450.00 euro, nga N.SH "Termovent", pa ndonjë arsye dhe arsyetim të bazuar mirë këtë kërkesë e ka refuzuar si të pa vlefshme. Arsyetimi i vendimit nga ana e AKP-së, se ankuesi është dashur që kërkesën e tij ta parashtrorë me kohë në gjykatë apo tek organi kompetent dhe se njëjta është parashkruar sepse në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (Gazeta zyrtare nr.53 të vitit 1976) kjo është dashur të bëhet në afat prej 3 viteve, nga data kur parashtruesit i

është ndërprerë marrëdhënia e punës me NSH-në, nuk qëndron dhe nuk përmban arsyet bindëse për refuzimin e kërkesës së tij. Padiësi kishte paraqitur kërkesën më 08 Nëntor 2013 në AL për kompensimin për paga të pa paguara, në shumë prej 450.00 euro, nga N.SH" Termovent", që është brenda aftit për paraqitjen e kërkesave tek AL. Pra, procedura e ndjekur nga padiësi kur i është drejtuar AL-së me kërkesën për kompensim është i drejtë. Me të njëjtin ligj është paraparë që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL, kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë padiësi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës. Mbrojtje e AKP-së është jo korrekte dhe ka për qëllim të i shmanget detyrimeve financiare të NSH-së ndaj padiësit.

Padiësi konsideron se neni 608 i Ligjit të punës së bashkuar pa bazë është zbatuar nga ana e AKP-së, e po ashtu pa bazë nga Gjykata është zbatuar edhe neni 353 par.1 të LMD-së me rastin e refuzimit të ankesës për shkak të parashkrimit.

Me 19 dhjetor 2023, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS, një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës së padiësit. AKP-ja i propozon Kolegjit të apelit që ta refuzojë ankesën e padiësit si të pa bazuar dhe ta vërtetojë Aktgjykimin e ankimuar. Në këtë parashtresë AKP-ja pohon se qëndrimin e saj lidhur me argumentet e Ankesës është qartësisht dhe mjaftueshmërisht i sqaruar në Mbrojtjen e parashtruar si dhe në Aktgjykimin me nr.C-IV.-14-5011 nga DHPGJS, pranë shkallës së I-re. Përsëritja e atyre argumenteve të cilat janë parashtruar më parë do të ishin të pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës, për këtë arsye pala kundërshtare kërkon nga Kolegji i ankesave që t'i referohet Mbrojtjes dhe Aktgjykimit përkatës.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e padiësit refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

## **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet .

Kolegji i Apelit vëren paditësi kishte dorëzuar kërkesë me datë 08 nëntor 2013 për kompensimin e pagave të pa paguara në shumë prej 450.00 euro, mirëpo AL e kishte refuzuar si e pa vlefshme me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në ankesën e tij të dorëzuar në Shkallën e I-rë, ka pohuar se ka qenë punëtor që nga viti 1980, fillimisht pranë N.SH "Termovent" e cila i është dhënë në komercializim "Dajti" sh.p.k e cila ka hyrë në fuqi në vitin 2001 për një afat 10 vjeçar dhe se tutje në këtë ndërmarrje ka punuar deri në privatizimin e kësaj ndërmarrje. Paditësi e konteston aplikimin e dispozitave ligjore, nga ana e gjykatës lidhur me parashkrimin duke e konsideruar se sipas rregullores së UNMIKU-ut 1999/24, këto dispozita ligjore nuk duhet të aplikohen.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-5011, tw dt. 22 shtator 2022, ankesën e paditësit e ka refuzuar si të pa bazuar dhe ka vërtetuar Vendimi i Autoritetit të likuidimit PRN045-0048, të datës 05 qershor 2014.

Kolegji i Apelit e mbështet konstatimin e Shkallës së I-rë të DHPGJS-së se duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe 5, po ashtu në bazë të nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS është obligim i palës, në këtë rast paditësit, që në parashtrirat e tij me shkrim, ankesën të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsyetimit ligjor mbi të cilin vendos qëndrimin dhe argumentimin e saj. Në rastin kur pala pohon, në këtë rast paditësi, të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi.

Me të drejtë e Shkalla e I-rë ka theksuar se lidhur me pagat e pa paguara si dhe kompensimit, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP-së, duke u bazuar në nenin 40 të Shtojcës së Ligjit për AKP mbi prioritetet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 parashihet përmbushja e kërkesave për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person të cilët janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në.

Edhe Kolegji i Apelit vlerëson se Shkalla e I-rë, drejtë ka konstatuar se nga dëshmitë e parashtruar, paditësi nuk ka dëshmuar të drejtën e tij mbi pagat ashtu siç edhe parashihet sipas nenit 40 të Shtojcës së Ligjit për AKP, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 por edhe nuk ka dëshmuar ndonjë obligim tjetër ashtu siç parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5, po ashtu nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS. Paditësi përveç pretendimit të tij në lidhje me pagat e paguara nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi të vlefshëm me të cilën do të dëshmohej se e paditura ai ka mbetur borxh atij.

Kolegji i Apelit gjithashtu vlerëson se janë të pabazuar pretendimet e paditësit se kërkesa e tij nuk është parashkruar dhe se ai ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe se paditësi e ka paraqitur kërkesën për kompensimin e pagave të pa paguara më kohe tek AL, pasi që vërehet se Shkalla e I-rë e DHPGJS në Aktgjykimin e saj nuk i referohet asnjëherë parashkrimit të kërkesës së pagave për paditësin, por Shkalla e I-rë siç edhe arsyetuar më lart kërkesën e paditësit për pagat e paguar e ka refuzuar për shkak se paditësi nuk ka dëshmuar me prova se a paditura i ka mbetura borxh paditësit.

Kolegji i Apelit sa i përket kërkesës së paditësit për lirim nga pagesa gjyqësore, ka konstatuar se duke u mbështetur në bazë të nenit 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit gjyqësor të Kosovës



(KGJK) nr.01/2017, të datës 22 mars 2017, nuk caktohen taksa gjyqësore, në këtë procedurë ankimore, pasi që vlera e kontestit është 1,000.00 euro.

Andaj nga këto arsye, ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar, dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

### **Taksat gjyqësore**

Në bazë të nenit 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr.01/2017, të datës 22 mars 2017, nuk caktohen taksa gjyqësore, në këtë procedurë ankimore, pasi që vlera e kontestit është 1,000.00 euro.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 14 mars 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues

\_\_\_\_\_